

Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në këtë informim do të mbulojmë zhvillimet në proceset gjyqësore që prej 14 dhjetorit 2023, ku përfshihen vendimet e marra gjatë pushimit dimëror të gjykatës, i cili përfundoi më 5 janar. Gjatë pushimit Gjykata ishte e hapur dhe puna vijoi në të gjitha njësitë e DHSK-së.

Në çështjen gjyqësore *Haxhi Shala*, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendosi më 14 dhjetor se gjuha e punës në këtë çështje gjyqësore do të jetë anglishtja, siç u kërkua si nga Prokuroria dhe mbrojtësi kujdestar i z. Shala. Konferenca e parë për ecurinë e çështjes u mbajt më 15 dhjetor, ku z. Shala kërkoi të vetëdeklarohet dhe u vetëdeklarua i pafajshëm në lidhje me tri akuzat e paraqitura në Aktakuzë.

Më 19 dhjetor, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi Vendimin Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje të Lidhura me Të, për të njëjtën çështje gjyqësore. Ndër të tjera, ky vendim cakton disa afate në janar dhe shkurt, brenda të cilave Prokuroria duhet t'i japë Mbrojtjes prova të kategorive të ndryshme. Ky proces njihet ndryshe si nxjerrja e provave.

Pas një kërkesë të mëhershme nga Prokuroria për të bashkuar çështjen e z. Haxhi Shala dhe çështjen e z. Januzi dhe z. Bahtijari në një gjykim të vetëm, Gjykatësi i Procedurës Paraprake dha urdhër me gojë më 14 dhjetor me të cilin urdhëroi Prokurorinë të dorëzonte aktakuzën e përbashkët të propozuar brenda 12 janarit.

Në dhjetor, Administratorja emëroi z. Xhonatan Elistan Ris si mbrojtës të z. Januzi dhe në janar emëroi znj. Felisiti Xherri (Felicity Gerry) si mbrojtëse të z. Ismet Bahtijari dhe z. Tobi Kadman si mbrojtës të z. Haxhi Shala.

Në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët*, më 15 dhjetor, Trupi Gjykues urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit në dy vendime të ndara.

Për të dy të akuzuarit, gjykatësit konstatuan se ekziston ende rreziku se do të pengojnë ecurinë e procesit dhe të kryejnë krime të tjera kundër atyre që konsiderohet se janë kundër UÇK-së, ku përfshihen dëshmitarët që kanë dhënë ose mund të japin dëshmi në këtë çështje. Trupi Gjykues është i mendimit se këto rreziqe mund të zvogëlohen vetëm me anë të kornizës së monitorimit të komunikimeve që përdoret në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, përfshirë masat e urdhëruara rishtazi nga Trupi Gjykues.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 15 dhjetor, Trupi Gjykues miratoi pjesërisht kërkesën e Prokurorisë për të pranuar si prova deklaratat me shkrim të disa dëshmitarëve, përfshirë të dëshmitarëve që kanë dhënë dëshmi në çështje të tjera dhe më pas kanë vdekur.

Ligji i DHSK-së, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, përcakton se dëshmitë e dhëna para TPNJ-së dhe gjykatave të Kosovës mund të pranohen në gjykime. Në përputhje me këtë, Rregullorja e Procedurës dhe Provave



përcakton se dëshmitë me shkrim të personave që ndërkohë kanë vdekur mund të pranohen në qoftë se gjykatësit binden se “deklarata, incizimi ose transkripti është *prima facie* i besueshëm ...”.

Si me të gjitha llojet e provave, u takon gjykatësve gjatë gjykimit të përcaktojnë peshën dhe vlerën e këtyre deklaratave në kontekstin e çështjes gjyqësore në përgjithësi.

Më 18 dhjetor, Trupi Gjykses në çështjen *Thaçi dhe të tjerët* autorizoi Prokurorinë t’i bënte redaktime të mëtejshme një prove shfajësuese, siç e lejon Rregullorja, për mbrojtjen e një dëshmitari.

Më 19 dhjetor, Trupi Gjykses miratoi pjesërisht kërkesat nga Mbrojtja e Krasniqit dhe Mbrojtja e Selimit për të apeluar një vendim të mëparshëm lidhur me atë nëse disa deklarata të mëparshme të të akuzuarve mund të pranohen si prova. Kryetarja e Dhomave të Specializuara caktoi gjykatësen Mishelë Pikar, gjykatësin Emilio Gati dhe gjykatësen Nina Jorgensen në Panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur në lidhje me këto aspekte.

Më 20 dhjetor 2023, Trupi Gjykses vendosi mbi ankesat e paraqitura nga z. Selimi (të cilave iu bashkuan z. Thaçi dhe z. Veseli) në lidhje me zbatimin e Vendimit të Trupit Gjykses të 1 dhjetorit për modifikimin e kushteve të paraburgimit për tre të akuzuarit. Trupi Gjykses e refuzoi kërkesën si të parakohshme, duke theksuar se këto kërkesa i dorëzohen fillimisht drejtpërdrejt Administratores dhe, në qoftë se refuzohen, të paraburgosurit mund të kërkojnë rishikim gjyqësor të vendimit të Administratores nga Trupi Gjykses.

Katër seanca që më parë ishin planifikuar të zhvilloheshin në shkurt në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët* u anuluan, pas një kërkesë nga Mbrojtja e Veselit. Trupi Gjykses konstatoi se Mbrojtja paraqiti arsye të vlefshme për të bërë një ndryshim të vogël të kalendarit, për të siguruar që aftësia e Mbrojtjes për t’u përgatitur për pyetjet e dëshmitarëve të ardhshëm të mos cenohej nga vdekja e papritur kohët e fundit një prej bashkëmbrojtësve të ekipit.

Më 3 janar 2024, Administratorja informoi Trupin Gjykses për miratimin e znj. Kerri An Rouan (Kerrie Ann Rowan) si bashkëmbrojtëse të z. Kadri Veseli.

Seanca e radhës në çështjen *Thaçi dhe të tjerët* do të mbahet të hënën, më 15 janar.

Seancat në çështjen *Pjetër Shala* rifilluan këtë javë. Dëshmitari i 10-të i thirrur nga Mbrojtja, Safet Gashi, dha dëshmi pa masa mbrojtëse, të martën dhe të mërkurën.

Gjatë seancës së djeshme, gjykatësit dhanë disa urdhra me gojë, një prej të cilëve kishte të bënte me një kërkesë të Mbrojtjes për të shtuar aktekspertizën e një psikologeje në listën e provave materiale në këtë çështje gjyqësore dhe për ta thirrur atë të japë dëshmi në sallën e gjyqit. Trupi Gjykses urdhëroi që dëshmitarja dhe aktekspertiza, për të cilat Trupi Gjykses konstatoi se janë relevante për përcaktimin e dënimit në rast se i dënuari shpallet fajtor, të shtohen në listën e dëshmitarëve dhe të provave të Mbrojtjes. Sidoqoftë, gjykatësit rrëzuan kërkesën që ajo të japë dëshmi në sallën e gjyqit.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 9 janar Trupi Gjykses lëshoi vendimin e pestë mbi redaktimet e transkripteve, ku përfshihej riklasifikimi si publik i disa pjesëve të seancave gjyqësore që u mbajtën në seancë private mes datave 23-25 tetor.



Në çështjen *Salih Mustafa*, versioni i redaktuar publik i Aktgjykimit të Apelit u lëshua në dhjetor dhe gjendet në faqen e internetit të DHSK-së.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

